



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:259174

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05499691

2023:262314

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa , duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.09/24 të datës 22.02.2024 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit P.G nga fsh.... -Kaçanik , dhe përfaqësueses së të dëmtuarës KEDS Sh.a Ferizaj, T. K., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.1687/23 të datës 29.11.2023, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, më datën 22.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.09/24 të datës 22.02.2024, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit P.G nga fsh....-Kaçanik , dhe përfaqësueses së të dëmtuarës KEDS Sh.a Ferizaj, T. K..

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1687/23 e datës 29.11.2023, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit P.G nga fsh....-Kaçanik, i lindur me datë 20.11.1981, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.1687/23 e datës 29.11.2023, e ka akuzuar të pandehurin P.G nga fsh....-Kaçanik, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 22.02.2024, palët në procedurë janë pajtuar që lënda penale e evidentuar si 2023:262314, të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi që çështja të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datën 22.02.2024, në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit, Nd.nr.09/24, në mes palëve në procedurë dhe atë të pandehurit P.G dhe përfaqësuesit të dëmtuarës KEDS Sh.a Ferizaj, T. K.

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

2023:262314 datë, 22.03.2024

Sekretarja Juridike

Indira Beqa

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.